



# **TREGUESIT STATISTIKOR TË SHËRBIMEVE POSTARE**

**Tremujori II 2023**

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore**

## Përmbajtje

I. HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME .....	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE.....	5
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare.....	5
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare .....	8
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar .....	7
4. Treguesit e shërbimit ekspres .....	8

## I . HYRJJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesor të tregut postar për tremujorin e dytë të vitit 2023, si edhe krahasimet me tremujorin e parë të vitit 2023 dhe me tremujorin e dytë të vitit 2022, i cili publikohet në faqen e internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al), në seksionin “Statistika rreth AKEP” - “Shërbimet Postare”.

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

## II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e dytë të vitit 2023 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP për periudhën e raportimit janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (30 subjekte):**
  1. Albanian Cargo Service sh.p.k. (A.C.S.)
  2. Albanian Delivery Express sh.p.k.
  3. ALOPOST sh.p.k.
  4. Balkan Courier & Logistics sh.p.k.
  5. BIPEX sh.p.k.
  6. Blendi Dokollari –Person Fizik (Flash Delivery Albania)
  7. DANDEX COURIER EXPRESS sh.p.k
  8. DHL International (Albania) sh.p.k.
  9. Elite Post sh.p.k.
  10. EXPRESS ALB 24 sh.p.k.
  11. Fast Express Post sh.p.k.
  12. GED sh.p.k. (ish B.E.D. sh.p.k.)
  13. GENIKI TAXYDROMIKI ALB sh.p.k
  14. Greenposta shpk
  15. I V Y sh.p.k.
  16. IDEX IdealExpress sh.p.k. (ish All In One Cool sh.p.k.)
  17. INTEX COURIER sh.p.k.

18. IPOST sh.p.k.
19. Milsped Albania sh.p.k.
20. Mr. COURIER sh.p.k.
21. NOEX Courier & Delivery sh.p.k
22. POSTA JONË sh.p.k.
23. POSTMAN sh.p.k
24. T.N.T Express Albania sh.p.k.
25. Top Post sh.p.k.
26. TURBOO ALBANIA sh.p.k.
27. Ultra C.E.P. sh.p.k.
28. Ulysses Enterprises sh.p.k.(Fedex)
29. United Transport sh.p.k. (Uni Trans)
30. Youth Albania Professional Services (YAPS)

Gjatë periudhës, nga tremujori i parë i vitit 2023 deri në tremujorin e dytë të vitit 2023, ka 5 subjekt të çregjistruar për ofrimin e shërbimeve postare dhe kanë raportuar të dhënat statistikore 24 subjekte<sup>1</sup>.

Posta Shqiptare me VKD Nr.13, datë 30.06.2020 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

---

<sup>1</sup> Ofrues të shërbimeve postare që kanë raportuar të dhënat statistikore në AKEP deri më datë 20.07.2023

### III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara nga ofruesit e shërbimeve postare përbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare;
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres.

#### 1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023 rezultojnë 5,118,346 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të dhëna në mënyrë më të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

**Tabela 1.1:** Të dhëna përmbledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara

Shërbime postare të ofruara		T2_2022	T3_2022	T4_2022	T1_2023	T2_2023	Ndryshim T2_2023/ T1_2023	Ndryshim T2_2023/ T2_2022
<b>Posta Shqiptare sh.a</b>								
<b>1</b>	<b>Shërbim Universal Postar</b>							
1.1	Postë brenda vendit	5,234,188	5,001,676	5,906,952	5,351,099	3,679,866	-31%	-30%
1.2	Postë ndërkombëtare	162,271	222,394	186,079	184,390	188,482	2%	16%
<b>1.3</b>	<b>Totali 1.1+1.2</b>	<b>5,396,459</b>	<b>5,224,070</b>	<b>6,093,031</b>	<b>5,535,489</b>	<b>3,868,348</b>	<b>-30%</b>	<b>-28%</b>
<b>2</b>	<b>Shërbim jouniversal postar</b>							
2.1	Postë brenda vendit	118,161	106,925	101,500	92,252	164,019	78%	39%
2.2	Postë ndërkombëtare	403	431	449	146	631	332%	57%
<b>2.3</b>	<b>Totali 2.1+2.2</b>	<b>118,564</b>	<b>107,356</b>	<b>101,949</b>	<b>92,398</b>	<b>164,650</b>	<b>78%</b>	<b>39%</b>
<b>3</b>	<b>Shërbim ekspres</b>							
3.1	Ekspres brenda vendit	140,469	119,412	124,731	126,129	126,802	1%	-10%
3.2	Ekspres ndërkombëtar	2,435	4,340	3,411	3,883	3,954	2%	62%
<b>3.3</b>	<b>Totali 3.1+3.2</b>	<b>142,904</b>	<b>123,752</b>	<b>128,142</b>	<b>130,012</b>	<b>130,756</b>	<b>1%</b>	<b>-9%</b>
<b>Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare</b>								
<b>4</b>	<b>Shërbim JoUniversal Postar</b>							
4.1	Postë brenda vendit	558,871	554,520	205,826	196,289	199,271	2%	-64%
4.2	Postë ndërkombëtare	14,456	9,575	4,429	2,819	4,295	52%	-70%
<b>4.3</b>	<b>Totali 4.1+4.2</b>	<b>573,327</b>	<b>564,095</b>	<b>210,255</b>	<b>199,108</b>	<b>203,566</b>	<b>2%</b>	<b>-64%</b>
<b>5</b>	<b>Shërbim ekspres</b>							
5.1	Ekspres brenda vendit	962,927	1,200,322	779,474	712,332	646,269	-9%	-33%
5.2	Ekspres ndërkombëtar	54,322	58,120	93,927	63,387	104,757	65%	93%
<b>5.3</b>	<b>Totali 5.1+5.2</b>	<b>1,017,249</b>	<b>1,258,442</b>	<b>873,401</b>	<b>775,719</b>	<b>751,026</b>	<b>-3%</b>	<b>-26%</b>
<b>6</b>	<b>Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3</b>	<b>7,248,503</b>	<b>7,277,715</b>	<b>7,406,778</b>	<b>6,732,726</b>	<b>5,118,346</b>	<b>-24%</b>	<b>-29%</b>

Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Në mënyrë të përmbledhur në vijim paraqiten disa nga zhvillimet kryesore në këtë treg:

### **Posta Shqiptare (Ofrues i Shërbimit Universal)**

- ✓ **Shërbim universal postar.** Ky zë në total ka pësuar rënie nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës dhe me 3 mujorin e mëparshëm, përkatësisht në masën 28% kundrejt T2 2022 dhe në masën 30% kundrejt T1 2023. Edhe zëri **Postë brenda vendit** ka pasur një rënie krahasuar si me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm në masën 30%, ashtu dhe me 3-mujorin e mëparshëm në masën 31%, ndërsa zëri **Postë Ndërkombëtare** ka një rritje nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të një viti më parë në nivelin 16%, e cila evidentohet gjithashtu duke e krahasuar dhe me 3-mujorin e mëparshëm në masën 2%.
- ✓ **Shërbimi Jo universal postar.** Ky zë në total ka pësuar një rritje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në nivelin 39% dhe një rritje të konsiderueshme nëse e krahasojmë me 3-mujorin e mëparshëm në nivelin 78%. Në të njëjtat nivele është dhe **Postë brenda vendit**. Edhe zëri **Postë ndërkombëtare** ka një rritje me 57% nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe një rritje të konsiderueshme me 332% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm.
- ✓ **Shërbimi Ekspres** Ky zë në total ka pësuar rënie nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 9% dhe rritje në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm në masën 1%. Në të njëjtat nivele është afërsisht dhe volumi i shërbimit **Ekspres brenda vendit** me një rënie në masën 10% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe një rritje prej 1% në krahasim me 3 mujorin e mëparshëm, ndërkohë që **Ekspres Ndërkombëtar** ka pësuar rritje si krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në masën 62%, dhe një rritje në masën 2% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm.

### **Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare**


- ✓ **Shërbimi Jo Universal Postar.** Ky zë ka një rritje në 3-mujorin e II 2023 në krahasim me 3-mujorin e I të 2023 në masën 2% ndërkohë që në krahasim me 3-mujorin II të vitit të kaluar kemi një rënie të ndjeshme prej 64%. Në të njëjtat nivele është dhe zëri **Postë brenda vendit**, kurse **Postë ndërkombëtare** ka një rritje prej 52% në krahasim me 3-mujorin e mëparshëm dhe një rënie të konsiderueshme prej 70% në krahasim me 3-mujorin I të vitit të kaluar.
- ✓ **Shërbimi ekspres.** Ky zë ka rënie në totalin e tij krahasuar me 3-mujorin e kaluar në masën 3%, dhe në masen 26% krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë që zëri i shërbimit **Ekspres brenda vendit** ka një rënie prej 9% krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm dhe një rritje në masën 33% krahasuar me vitin e kaluar.

**Tabela 1.2:** Totali i objekteve postare-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T2 2023

Totali i objekteve postare		
	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	4,163,754	81%
<i>Of. e tjerë</i>	954,592	19%
<b>Totali</b>	<b>5,118,346</b>	<b>100%</b>

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

**Grafiku 1.1:** Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, shikojmë një rënie në objektet postare në T2\_2023 krahasuar me T1\_2023 si për Postën Shqiptare ashtu edhe për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare. Gjithashtu, krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë kemi një rënie të totalit të objekteve postare si për Postën Shqiptare ashtu dhe për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.


**Tabela 1.3:** Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T2\_2023

Sh.U	Sh. jo univers.	Sh.ekspres	Totali
3,868,348	368,216	881,782	5,118,346
76%	7%	17%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me 76%, ndjekur nga shërbimi ekspres me 17% dhe shërbimi jo universal 7 %.

**Grafiku 1.2:** Ecuria në 3-mujor sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar. Nga krahasimi i periudhës T2\_2023 me periudhën T1\_2023 vërehet që kemi një rënie në masën 24% në volumin total të shërbimeve postare. Kjo rënie evidentohet duke e krahasuar edhe me të njëjtën periudhë një vit më parë në masën 29%.

## 2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare

**Tabela 1.4:** Shërbimi Universal Postar T2\_2023

Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	3,679,866
Postë ndërkombëtare	188,482
<b>Totali</b>	<b>3,868,348</b>


Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga të dhënat e tabelës 1.4 për T2\_2023, për sa i përket shërbimit Universal Postar, vihet re se Posta Shqiptare realizoi gjithsej 3,868,348 objekte, nga të cilat posta brenda vendit zë 95% të objekteve postare dhe posta ndërkombëtare zë 5% të objekteve postare. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 2,825,965 shërbime për objekte të thjeshta dhe 853,901 shërbime për objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 38,859 objekte postare të pranuar në Shqipëri



dhe të dërguara jashtë vendit dhe 149,623 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

**Grafiku 1.3:** Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 muajor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga grafiku i mësipërm, shikohet një rënie e shërbimit universal postar në T2\_2023 krahasuar me T1\_2023, me 30%.

### 3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare

Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:


**Tabela 1.5:** Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Sh

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesa tregut T_2 2023	Pjesa tregut T_2 2022
Shërbim universal postar	3,868,348	92.9%	95.4%
Shërbim jo universal postar	164,650	4.0%	2.1%
Shërbim ekspres	130,756	3.1%	2.5%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare, që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 92.9%, i ndjekur nga shërbimi jo universal postar me 4.0% dhe nga shërbimi ekspres 3.1%. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kemi një rritje të vogël Shërbimit jo universal postar dhe të Shërbimit ekspres.

**Grafiku 1.4:** Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare, ku vihet re një rënie e shërbimit universal dhe një rritje e atij jo universal dhe rënie për shërbimin ekspres në T2\_2023 krahasuar me T1\_2023.

#### 4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

**Tabela 1.6:** Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T2_2023	Pjesë tregu T2_2022
P.Sh	164,650	45%	17%
Of. e tjerë	203,566	55%	83%
<b>Totali</b>	<b>368,216</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

**Grafiku 1.5:** Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në T2\_2023 krahasuar me T1\_2023 kanë pasur rritje në total në masën 26% ku për Postën Shqiptare rritja është 78% ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare rritja është 2%

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë T2 2023 përbëhet nga 363,290 objekte brenda vendit dhe 4,926 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.

### 5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të dytë të vitit 2023, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2022, mbi baza tremujore.

**Tabela 1.7:** Shërbimi ekspres-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për T2\_2023

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T2_2023	Pjesë tregu T2_2022
P. Shqiptare	130,756	15%	12%
Of. e tjerë	751,026	85%	88%
<b>Totali</b>	<b>881,782</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

**Grafik 1.6:** Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Shërbimi ekspres, gjatë T2\_2023 ka pësuar rënie në krahasim me T1\_2023 në masën 3% dhe në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar rënie në masën 24%. Duhet theksuar se ndikimin më të madh në këtë rënie e kanë Ofruesit e tjerë.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë së bashku është në vlerën 773,071 objekte postare ose 88% e totalit të këtij shërbimi, ndërsa shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 108,711 objekte postare ose 12% e totalit të këtij shërbimi për periudhën raportuese.

Për sa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri është në vlerën 82,864 objekte dhe sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit është në vlerën 25,847 objekte.